

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Folksvagen Akciengesellschaft, Gjermani do të fitoj kontroll të pavarur mbi NIRA Dajnemiks AB, Mbretëria e Suedisë**

**(lënda nr. 08-19 datë 16.01.2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 16.01.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Folksvagen Akciengesellschaft me seli në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani mbi shoqërinë NIRA Dajnemiks AB me seli në Vallenbergs gata 4, 583 30 Linköping, Suedi, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

- **Folksvagen Akciengesellschaft**, merr pjesë në transaksionin e propozuar përmes shoqërisë së saj tërësisht në pronësi të **KARIAD SE** me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani.

Folksvagen Akciengesellschaft është një shoqëri e tregtuar në bursë, me seli në Wolfsburg (Gjermani) dhe shoqëri udhëheqëse e Grupit Volksvagen.

Grupi Volkswagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit (*coaches*), shasive të autobusëve dhe motorëve me naftë, motoçikletave, duke përfshirë pjesë rezervë dhe pajisje shtesë. Grupi Volkswagen është gjithashtu i angazhuar në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

- **Porshe Lizing SHPKNJP Shkup**, me seli në Bul., Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup dhe me aktivitet bazë të regjistruar - Lizing financiar;

- **Porshe Broker SHA Shkup**, me seli në Bul. Bosnje dhe Hercegovinaë nr. 3, Shkup dhe me veprimtari kryesore të regjistruar - veprimtari të agjentëve të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit;

- **Skania Makedonija SHPKNJP Ilinden**, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe me veprimtari kryesore të regjistruar - tregti me mjete të tjera motorike dhe

- **Porshe MaKedonija SHPKNJP Shkup**, me seli në Bul. Bosnjë dhe Hercegovina nr. 3, Shkup dhe me aktivitet kryesor të regjistruar - tregtimin e veturave dhe mjeteve motorike të kategorisë së lehtë.

- NIRA Dajnemiks AB fokusohet në kërkimin dhe zhvillimin e zgjidhjeve softuerike për të përmirësuar sigurinë, veçanërisht sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit për industrinë e automobilave. Shoqëria fiton të ardhura kryesisht nga tarifat për dhënien e licencave.

Më konkretisht, NIRA Dajnemiks AB është aktive në zhvillimin dhe integrimin e zgjidhjeve softuerike inteligjente, funksionimi i të cilave mbështetet në bashkimin e të dhënave të sensorëve dhe përdorimin e të dhënave të sistemit cloud dhe që janë komponentë softuerësh të sistemeve të avancuara të ndihmës së shoferit.

NIRA Dajnemiks AB nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin e propozuar mund të përkufizohet si treg për **zgjidhjet e integruara NSPV ADAS, duke përfshirë softuerin NSPV ADAS.**

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

17.01.2023

Shkup